

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Forcohet fronti anti-Veliaj në PS? Saimir Tahiri paralajmëron: Do shihemi së shpejti, kam shumë për të thënë - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/forcohet-fronti-anti-veliaj-ne-ps-saimir-tahiri-paralajmeron-do-shihem-i-se-shpejti-kam-shume-per-te-thene/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 15:16:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 15:11:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a599f7b01a6ce163af5e9d356cffdbf691cfa547fb8ad8d91f987c8887c20827
TEKSTI	64bf475f14149419f3260892fe451315ef7b7077a33e8aa8a6fe94da7f5fec88
PAMJA	9e776edb9751e90ae62e5bc4b585aaf7e219eecd15abb989a435cc5310b4e70b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7c10b1bf99dd4961b8a79da6a5f12805bb93d5d46cc9dbfdf40eda60a4ff48d9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c646a932fde53c288233dea515333d4375993381cb212e1a0a5e6c9db33460b4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, në **radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7c10b1bf99dd4961b8a79da6a5f12805bb93d5d46cc9dbfdf40eda60a4ff48d9>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Forcohet fronti anti-Veliaj në PS? Saimir Tahiri paralajmëron: Do shihemi së shpejti, kam shumë për të thënë

by Sport Sport — September 26, 2026 in Aktualitet, Kryesore, Politike

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Diçka po lëviz sërish rreth Saimir Tahirit. Pas viteve të heshtjes dhe një profili pothuajse të zhdukur nga skena politike, ish-ministri i Brendshëm ka zgjedhur pikërisht këtë moment për të paralajmëruar rikthimin.

"Disa histori i kam jetuar. Disa të tjera i kam dëgjuar të tregohen për mua. Do shihemi së shpejti. Ka kaq shumë për të thënë", është mesazhi i tij.

Zyrtarisht bëhet fjalë për një prodhim multimedial në bashkëpunim me median e tij "Zëri", ku Tahiri pritet të rrëfejë versionin e tij për vitet më të trazuara të karrierës politike. Por momenti kur ai vendos të flasë e bën historinë shumë më interesante se një dokumentar.

Sepse Tahiri nuk po rikthehet në një PS të qetë.

Erion Veliaj ndodhet në burg dhe raportet e forcave brenda socialistëve kanë ndryshuar. Belinda Balluku, një prej figurave me të cilat është përfolur së fundmi një afrim i Tahirit, vazhdon betejën e saj me SPAK-un. Ndërkohë, prej muajsh qarkullojnë informacione për vizita të ish-ministrit në selinë rozë dhe madje për një zyrë që i është vënë në dispozicion aty, ndonëse këto të dhëna nuk janë konfirmuar publikisht.

Kjo e bën rikthimin e Tahirit politikisht interesant.

Për vite me radhë, Tahiri dhe Veliaj përfaqësuan dy prej figurave më të forta të brezit të ri socialist të ardhur në pushtet me Edi Ramën. Karrierat e tyre morën më pas drejtime krejt të ndryshme: Tahiri doli nga politika dhe përfundoi përballë drejtësisë, ndërsa Veliaj ndërtoi pushtetin e tij në Tiranë dhe brenda PS-së.

Sot skena është përmbytur. Veliaj është jashtë lojës politike aktive, ndërsa Tahiri po del nga heshtja.

Dhe pikërisht këtu fjalja "ka kaq shumë për të thënë" merr një kuptim tjetër.

Çfarë do të tregojë Saimir Tahiri? Vetëm historinë e tij me drejtësinë dhe largimin nga qeveria? Marrëdhënien me Edi Ramën? Apo edhe historitë e pathëna të betejave brenda Partisë Socialiste?

Ende nuk dihet.

Por një gjë është e qartë: rikthimi i Tahirit nuk po ndodh në boshllëk. Ai vjen në një moment kur brenda PS-së po riformatohen raportet e forcës dhe kur mungesa politike e Erion Veliajt ka lënë një hapësirë që shumëkush kërkon ta zërë.

Nëse Tahiri po kthehet vetëm për të treguar historinë e tij apo për t'u bërë përsëri pjesë e historisë së PS-së,

TË FUNDIT

Forcohet fronti anti-Veliaj në PS? Saimir Tahiri paralajmëron: Do shihemi së shpejti, kam shumë për të thënë

SEPTEMBER 26, 2026

Historiku i përballjeve me Bjellorusinë, Shqipëria ka bilanc pozitiv

SEPTEMBER 26, 2026

Eric Wendt merr zyrtarisht detyrën si ambasador i SHBA-së në Shqipëri, zbardhet takimi me presidentin Begaj

SEPTEMBER 26, 2026

Ra në kontakt me energjinë elektrike teksa punonte në një varkë, ndërron jetë 28-vjeçari filipinez

SEPTEMBER 26, 2026

Konflikt me armë e sende të forta në Tiranë/ 54-vjeçari qëllon 33-vjeçarin, zbardhen detajet

SEPTEMBER 26, 2026

"Ka pranuar marrëdhënien jashtëmartesore me Ballukun"/ Elton Qyno zbardh deklaratën e bujshme të Igli Tares në SPAK

SEPTEMBER 26, 2026

A është gjetur Bleona Mata? Avokati sqaron përplasjen me nënën e vajzës së zhdukur

SEPTEMBER 26, 2026

FOTO/ Tragjedi për familjen shqiptare, motër e vëlla mes viktimave në Athinë

SEPTEMBER 26, 2026

10 ambasadorët e SHBA-së në Tiranë që prej vitit 1991, nga Ryerson te Yuri Kim

SEPTEMBER 26, 2026

Sulmi me kallashnikov ndaj kafenesë shqiptare në Athinë/ Dyshohet se urdhri erdhi nga burgu

SEPTEMBER 26, 2026

kjo mbetet per t'u pare.

Por paralajmërimi i tij është zgjedhur mirë:

“Do shihemi së shpejti.”

Previous Post

Historiku i përballjeve me Bjellorusinë,
Shqipëria ka bilanc pozitiv



Sport Sport

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencja dhe vërtetësia, portali synon t’u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja
mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

0 SHARES



Shkarkohet Ilir Topi/ Ish-drejtimesja e CFO Pharma, Rexhina Bici pritet të drejtojë Fondin e Sigurimeve

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.